

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 035

EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE

Aktivitete për klasë

Tipi i programit: Plotësues

Hyrje

Programi i trajnimit “Edukimi për drejtësi shoqërore” është zhvilluar për të mbështetur zhvillimin profesional të mësimeve dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijë, të rinj dhe komunitete të ndryshme, me synim forcimin e njohurive dhe kompetencave për promovimin e barazisë, përfshirjes dhe të drejtave të njeriut. Programi ofron një qasje të bazuar në drejtësinë shoqërore, duke trajtuar mekanizmat e diskriminimit, pabarazisë dhe përjashtimit social, si dhe rolin e edukimit në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

Fillimisht, programi është konceptuar për profesionistët që punojnë me grupe të marginalizuara, duke synuar zhvillimin e aleatëve të aftë për të mbështetur pjesëmarrjen, fuqizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre grupeve. Programi është hartuar nga ISSA (International Step by Step Association) në bashkëpunim me ekspertë të fushës së të drejtave të njeriut dhe edukimit për drejtësi shoqërore. Të drejtat për ofrimin dhe zbatimin e programit janë transferuar te KEC, që zbaton atë në kuadër të programeve të saj të zhvillimit profesional.

Qëllimet e programit:

Programi i trajnimit “Edukimi për drejtësi shoqërore” ka për qëllim zhvillimin e vetëdijes kritike dhe kompetencave profesionale për njohjen, vlerësimin dhe promovimin e diversitetit kulturor, gjuhësor dhe etnik si vlerë themelore njerëzore. Programi fokusohet në ndërtimin e qëndrimeve gjithëpërfshirëse, në dekonstruktimin e paragjykimëve dhe stereotipeve, si dhe në forcimin e tolerancës dhe zhvillimit të dialogut ndërkulturor. Përmes një qasjeje të integruar teorike dhe praktike, pjesëmarrësit aftësohen të kontribuojnë në krijimin e mjediseve demokratike, të drejta dhe të barabarta, duke nxitur respektimin e të drejtave të njeriut dhe barazinë në nivel individual, shoqëror dhe institucional.

Me përvetësimin e këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:

- Përforcojnë vetë-konceptin e fëmijëve dhe identitetet grupore duke pranuar, respektuar dhe afirmuar të gjitha kulturat dhe përvojat e fëmijëve,
- Përforcojnë marrëdhëniet e shkollës me familjet dhe komunitetet duke i inkadruar në materialin mësimor, si bazë për mësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, që vijnë drejtpërdrejtë nga familjet dhe komunitetet,
- Nxisin fëmijët të hulumtojnë dhe kërkojnë zgjidhje për padrejtësitë shoqërore të cilat ata mund t'i hasin,

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

- Mësojnë si të nxisin të menduarit kritik të fëmijët, rreth keqinterpretimeve, stereotipeve dhe paragjyimeve,
- Jenë me të hapur për të përfshirë grupet e ndryshme etnike dhe gjejnë forma dhe sugjerime për lehtësimin e këtij procesi.

Përmbajtja

Shkathtësitë e mësuara në trajnim ndërtohen mbi Standardet Pedagogjike të ISSA (International Step by step Association) për: individualizimin për të vlerësuar diversitetin në mesin e nxënësve dhe familjeve; pjesëmarrjen e familjes; krijimin e ambienteve mësimore gjithëpërfshirëse; hartimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme mësimore që promovojnë bashkëpunimin; hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe planifikimin dhe vlerësimin e mësimnxënies.

Programi përbëhet nga dy qasje të ndërlidhura dhe përfshinë këto tema:

Pasurimi i njohurive teorike: Thellimi i të kuptuarit të koncepteve kyçe si kultura, dallimet sociale dhe kulturore, mekanizmat e menaxhimit të diversitetit, zhvillimi i identiteteve të shumfishta, si dhe drejtësia sociale, përfshirë mekanizmat që prodhojnë pabarazi dhe ushqejnë shtypjen, dallimin mes barazisë dhe barazimit dhe manifestimet e tyre në fusha të ndryshme të jetës. Po ashtu, forcimi i vetëdijes për rolin personal në nxitjen e ndryshimit shoqëror përmes aktivizmit dhe ndërtimit të aleancave.

Përmirësimi i shkathtësive praktike: Zhvillimi i shkathtësive për të vepruar në mënyrë efektive në dhe për kontekste të ndryshme, përmes dekonstruktimit të stereotipeve dhe paragjyimeve, forcimit të ndjeshmërisë dhe kompetencave ndërkulturore, përmirësimit të komunikimit ndërkulturore, si dhe ndërmarrjes së veprimeve të përgjegjshme. Kjo përfshin edhe përkushtimin ndaj një procesi të vazhdueshëm të ndërtimit të kapaciteteve për transformim personal, profesional dhe institucional.

Programi Edukimi për Drejtësi Shoqërore zgjeron dhe thellon njohuritë në këto fusha, duke i prezantuar strategjitë për:

- zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetet që tradicionalisht janë të marginalizuara në sistemin shkollor;
- përfshirjen e zërit të fëmijëve dhe familjeve në hartimin e programeve;
- promovimin e kapacitetit të nxënësve për bashkëpunim, negociata dhe mendim kritik duke u siguruar nxënësve mundësi për të përfutur përvojë përmes një llojllojshmërie perspektivash dhe duke modeluar respekt për këndvështrime të ndryshme;
- zhvillimin e njësive dhe aktiviteteve të integruara që i adresojnë apo inkorporojnë çështjet e drejtësisë shoqërore duke përdorur tema që janë pjesë e Kurrikulës Kombëtare të Kosovës, tregime të zakonshme të fëmijëve dhe tema të cilat i iniciojnë fëmijët nga interesat dhe përvojat e tyre (për shembull, drejtësia, përfshirja, bashkëpunimi, si të zgjidhet konflikti dhe

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

ndërprerja e stereotipeve negative); nxënësit gjithashtu fitojnë shkathtësi akademike dhe jetësore të përshtatshme për moshën e tyre.

Grup i synuar

Ky program u dedikohet të gjithë atyre që punojnë me fëmijët dhe dëshirojnë t'i ndihmojnë ata që t'i njohin, kuptojnë dhe respektojnë dallimet shoqërore.

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi zhvillohet në formë të trajnimit treditor dhe përfshin demonstrimin e realizimit praktik të aktiviteteve në klasë, me gjithsej 24 orë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është vijueshmëria e së paku 90% të trajnimit. Po ashtu, pjesëmarrësit obligohen që, brenda tri javëve pas përfundimit të programit të trajnimit, të paraqesin dëshmi për realizimin e së paku tri aktiviteteve me fëmijë, të cilat trajtojnë tema që lidhen me drejtësinë shoqërore.